

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mbi 500 telefonata e mesazhe mes Hysenit dhe Agasit/ Si ranë në duart e hetuesve përgjimet e forta - R EPORT.AL
ADRESA	https://report.al/mbi-500-telefonata-e-mesazhe-mes-hysenit-dhe-agasit-si-rane-ne-duart-e-hetuesve-pergjimet-e-forta/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:01:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 13:00:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ca268759118348f966622c8a809128bfe8d5375f70bb89dff748fb2c4380a3e9
TEKSTI	f44c059b66c9247b476a9855532f4aad53b9e23d0b04c43206602e189a2dfa70
PAMJA	ab85c2d79a700cbb2cd76a01959d594f5f80995c0198b81a1e0aa90e4033b18

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	28721708bbb973f198935cf71d7843751747de1e64a066a9eea3b11d0f5e1784
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/28721708bbb973f198935cf71d7843751747de1e64a066a9eea3b11d0f5e1784>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Mbi 500 telefonata e mesazhe mes Hysenit dhe Agasit/ Si ranë në duart e hetuesve përgjimet e forta

by Lajm Lajm — September 23, 2026 in Aktualitet, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

BoldNews.al

Fillimi AKTUALITET

Mbi 500 telefonata e mesazhe mes Hysenit dhe Agasit/ Si ranë në duart e hetuesve përgjimet e forta

14:15 : 23/09/2026

Mbi 500 komunikime mes kreut të SHISH, Viora Hyseni, dhe personit nën hetim Ergys Agasi kanë përfunduar në duart e hetuesve të SPAK, duke nxjerrë në pah një komunikim të shpeshtë dhe të vazhdueshëm mes tyre.

Bëhet fjalë për telefonata, videotelefonata, mesazhe dhe forma të tjera komunikimi të evidentuara në telefonin e Agasit gjatë periudhës 28 qershor–26 gusht 2026, dita kur Agasi u arrestua.

Në dosjen hetimore, SPAK evidenton se në funksionin "BIOME" të telefonit të Agasit janë gjetur gjithsej 508 komunikime me Vlorën Hyseni.

"Në lidhje me komunikimet ndërmjet Ergys Agasit dhe Viora Hysenit, të ruajtura në funksionin BIOME të aparatit telefonik të shtetasit Ergys Agasi janë të ruajtura gjithsej 508 forma komunikimi (calls, voice, video calls, messages, chat messages) ndërmjet këtyre dy shtetasve për periudhën e sipër-cituar."

Por si përfunduan këto të dhëna në duart e hetuesve?

Sipas dosjes hetimore, gjurmët e komunikimeve u administruan gjatë hetimit që pasoi sekuestrimin e automjetit të Agasit. Më 20 korrik 2026, në ambientet e "Equos Resort" në Tiranë, u sekuestrua automjeti me targë GG444AA, në pronësi të tij.

TË FUNDIT

Thirrja e Gent Prognit për qytetarët: Nesër në 09:00 te Kuvendi, dilni për familjen tuaj. Nëse jemi shumë, do ju dridhen këmbët

SEPTEMBER 23, 2026

Arrestohet Shpëtim Aliu në Rusi, një nga "kokat" e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës

SEPTEMBER 23, 2026

Ambasadorja e BE takohet me kryetaren e KLP: Një sistem i fortë drejtësie është thelbësor për të ardhmen e Shqipërisë

SEPTEMBER 23, 2026

Pankartat ironizuese: "Nga Belinda te SHISH-i, krejt ekipi në pranga! Jep dorëheqjen Edi Rama, nuk të shpëton dot as banda

SEPTEMBER 23, 2026

Edison Lika: Qëndresa çdo ditë në shesh po gërryen pushtetin e qeverisë, kryeministri do të bjerë si tigër prej letre

SEPTEMBER 23, 2026

Aktivistja i këndon këngë deputetes së PS: Zegjine o Zegjine, ti nuk di të numërosh, shko në shkollë të mësosh! Plas debati

SEPTEMBER 23, 2026

"Shqipëria kërkon revolucion"/ Sot dita e 116-të e protestës, qytetarët të vendosur deri në largimin e qeverisë: Rama, jep dorëheqjen!

SEPTEMBER 23, 2026

Arrestohet polici në Klos, dyshohet se ushtroi dhunë ndaj një vajze dhe vëllait të mitur të saj

SEPTEMBER 23, 2026

Berisha: Balluku ka vjedhur miliona euro, ndërsa Lubia e SHISH sigurinë kombëtare! Qeveria ka marrë goditjen më të rëndë

SEPTEMBER 23, 2026

Gazetari trondit me deklaratën: Dyshime të forta për lidhjen e Neritan Nallbatit me Ergys Agasin

SEPTEMBER 23, 2026

Gjatë veprimeve hetimore, në automjetet u gjetën dhe u sekuestruan, ndër të tjera, nëntë printime në letër të formatit të madh, në të cilat paraqiteshin diagrama me të dhëna që, sipas SPAK, kishin ngjashmëri me materiale të prodhuara nga Shërbimi Informativ i Shtetit.

Më 22 korrik, sendet u formalizuan përmes procesverbalit të sekuestrimit. Ndërkohë, hetimi vijoi edhe mbi pajisjet dhe komunikimet e Agasit, duke nxjerrë në pah numrin e lartë të kontakteve me kreun e SHISH.

Vetë Agasi, gjatë seancës gjyqësore për verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, ka pranuar se automjeti ishte i tij dhe se sendet e gjetura në të i kishte lënë me qëllim që të gjendeshin nga organet e Prokurorisë së Posaçme.

Përveç 508 formave të komunikimit të ruajtura në telefon, hetuesit kanë analizuar edhe komunikimet përmes aplikacionit "Signal".

Sipas të dhënave të administruara në dosje, vetëm në këtë aplikacion rezultojnë 70 telefonata hyrëse nga Vlora Hyseni drejt Ergys Agasit, 28 telefonata të humbura, 25 telefonata pa përgjigje dhe telefonata të tjera të refuzuara.

Pra, bëhet fjalë jo vetëm për komunikime të shkëmbyera në mënyrë sporadike, por për një kontakt të përsëritur dhe të zgjatur në kohë, i cili, sipas hetuesve, ka vijuar edhe gjatë periudhës kur Agasi ishte në kërkim nga drejtësia.

"Nga përmbajtja e komunikimeve mes tyre rezulton ekzistenca e një lidhjeje personale dhe e vazhdueshme, e cila ka vijuar edhe gjatë kohës kur shtetasi Ergys Agasi ka qenë i shpallur në kërkim nga drejtësia."

Në dosje theksohet se komunikimet nuk kanë qenë vetëm telefonata të zakonshme. Hetuesit kanë evidentuar edhe video-call, shkëmbim fotosh dhe videosh, si dhe komunikime të tjera.

"Komunikimi i Kreut të SHISH, shtetases Vlora Hyseni, me person nën hetim Ergys Agasi, deri në atë kohë dhe në kërkim nga drejtësia, është periodik (1 përditshëm) dhe i tejzgjatur në kohë bisede duke përfshirë jo vetëm telefonata të tjeshta (voice call) por dhe telefonata me video (video call) dhe dërgim e marrje fotosh e videosh."

Pikërisht përmbajtja e këtyre komunikimeve është një prej elementeve që SPAK e ka vendosur në fokus të hetimit. Sipas materialit hetimor, në disa prej bisedave Hyseni shfaqet e lidhur drejtpërdrejt me interesat e Agasit përballë organeve të drejtësisë.

"Në disa prej komunikimeve, shtetasia Vlora Hyseni identifikohet drejtpërdrejt me interesat e Ergys Agasit kundrejt organeve të drejtësisë që po e ndiqnin penalisht."

Ky konstatim i hetuesve vihet përballë edhe deklarimeve të dhëna nga Vlora Hyseni më 18 shtator 2026, kur ajo u pyet në cilësinë e personit me dijeni për veprën penale.

Hyseni ka pranuar komunikimin e vazhdueshëm me Agasin deri në ditën e arrestimit të tij dhe ka deklaruar se ai i kishte ofruar "bashkëpunim". Ajo ka mohuar takime fizike me të dhe ka mohuar që Agasi të kishte siguruar informacione nga SHISH.

Por, sipas SPAK, përmbajtja e komunikimeve të administruara gjatë hetimit paraqet një dinamikë tjetër.

"Ashtu sikurse rezulton nga bisedat e mësipërme, shtetasi Ergys Agasi jo vetëm që nuk është në rolin e bashkëpunimit, por edhe ka qenë në kontakt me personin në kërkim nga drejtësia."

bashkëpunëtorit, por ne të kufizuar është ai që merr dhe dikton informacionin e marrë.

Në dosje ngrihet gjithashtu një tjetër pikëpyetje mbi mënyrën se si është trajtuar brenda SHISH marrëdhënia me Agasin. Sipas hetuesve, për personin që pretendohet si "bashkëpunëtor" nuk ishte vënë në dijeni asnjë prej instancave të tjera të institucionit.

"Për më tepër, për të ashtuquajturin bashkëpunëtor, Kreu i SHISH nuk ka vënë në dijeni asnjë nga instancat qoftë dhe paralele apo brenda institucionit."

Të dhënat e telefonit dhe komunikimet përmes "Signal" tashmë janë pjesë e materialit që SPAK po analizon për të përcaktuar natyrën e marrëdhënies mes Hysenit dhe Agasit dhe rolin e secilit në ngjarjet nën hetim.

Tags: akshi Ergys Agasi hetime shish spak vlora hyseni

Previous Post

Berisha: Rama e ka përdorur Viora Hysenin për të rrëzuar qeverinë në Kosovë

Next Post

Përkallëzohet bojkoti i avokatëve/ Nuk marrin pjesë as në seancat për masat e sigurisë



Lajm Lajm

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparenca dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë në Dibër, 22-vjeçarja mbytet në lumin Drini i Zi

0 SHARES

01



Është studente ekselente, e birësuar nga një çift grek/ Trondit avokati: Bleona Mata është gjallë

0 SHARES



Falsifikime dhe shpërdorim detyre, pezullohen 2 zyrtarë në Tiranë

0 SHARES

© 2025 REPORT.AL

Aktualitet / OP-ED / Politike / Rajon / Showbiz / Sociale / Shëndet / Sport

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.